

**VENDIM**  
**Nr. 202, datë 25.3.2021**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 645, DATË 3.8.2020, TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR**  
**FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTEZA**  
**(PALLAT) DHE NDËRTESAVE PUBLIKE, NË ZONAT E REJA PËR ZHVILLIM,**  
**NË NJËSITË ADMINISTRATIVE 4 E 8, ZONA ‘5 MAJI’, DHE NJËSINË**  
**ADMINISTRATIVE 6, ZONA ‘KOMBINAT’, BASHKIA TIRANË”, TË**  
**NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nëndarja “i”, 16, pika 3, dhe 36, pika 1, shkronja “a”, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Pas pikës 2, të vendimit nr. 645, datë 3.8.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2.1, me këtë përmbajtje:

“2.1 Përdorimi i fondit për vitin 2021 të jetë në masën 1 990 233 627 (një miliard e nëntëqind e nëntëdhjetë milionë e dyqind e tridhjetë e tre mijë e gjashtëqind e njëzet e shtatë) lekë dhe i transferohet Bashkisë Tiranë për financimin e rindërtimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe ndërtesave publike, në zonat e reja për zhvillim, në njësitë administrative 4 e 8, zona “5 Maji”, dhe Njësinë Administrative 6, zona “Kombinat”, Bashkia Tiranë, në formën e transfertës së pakushtëzuar.”.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Erion Braçe**